

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6983  
E mërkurë, 30 gusht 2023  
Çmimi 0.40

KE-ja thotë se fokusohet në zgjerim dhe jo në afate kohore

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"


AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

RAUNDI I RI I BISEDIMEVE KOSOVË - SERBI PARASHIHET TË MBAHET NË SHTATOR

## KURTI: NORMALIZIMI I RAPORTEVE ME SERBINË ËSHTË I VËSHTIRË

FAQE 4-5

### AKTUALE



PROKURORIA E KOSOVËS DHE AJO E MAQEDONISË SË VERIUT SYNOJNË RRIJTJEN E BASHKËPUNIMIT F. 7

NËNSHKRUHET MEMORANDUMI PËR DIGJITALIZIMIN E SISTEMIT NOTERIAL F. 7

LËVIZJA VETËVENDOSJE VLERËSON BASHKËPUNIMIN ME FES-in F. 5

### EKONOMI



Reagim i KMDLNj-së

NDËRTIMTARIA, SEKTORI KU MË SË SHUMTI RREZIKOHET JETA E PUNËTORËVE! F. 8

KOSOVA NË FORUMIN STRATEGJIK TË BLEDIT, TEMË DISKUTIMI EDHE SEKTORI TIK-ut F. 8

### SPORT



26 SPORTISTË PËRFAQËSOJNË KOSOVËN NË 'HERAKLION 2023' F. 10

BSF  
Bled Strategic Forum

"De facto and de iure recognition are divided in the Balkans. You have de facto recognition somewhere without de iure and somewhere else de iure without de facto and this has to be settled."

**Albin Kurti**  
Prime Minister of Kosovo

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se shteti i tij është për normalizimin e raporteve me Serbinë dhe se kjo është e mundur pavarësisht se është një

proces i vështirë, por homologia e tij serbe, Ana Bërnabiq, ka theksuar se prioritet për Beogradin është themelimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Këto komente të dy i bënë gjatë një diskutimi të udhëheqësve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në hapje të Forumit të Bledit në Slloveni

AMERIKANËT MENDOJNË SE BIDENI ËSHTË "SHUMË I MOSHUAR", TRUMPI ËSHTË "I KORRUPTUAR"



TEKSTET SHKOLLORE, HARADINAJ TAKON JASHARAJN: NUK E KUPTOJ PAFYTYRËSINË E KURTIT DHE TË NAGAVCIT F. 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Mqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030-500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Gjyqi ndaj Donald Trumpit do të fillojë në mars 2024

WASHINGTON, 29 GUSHT - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, do të dalë në gjyq më 4 mars 2024 në një gjykatë federale në Uashington, nën akuzat se u përpoq ta zhbente disfatën në zgjedhjet presidenciale 2020.

Vendimi 28 gushtit i gjykatës federale, Tanya Chutkan, nënkupton se Trumpi me gjasë do të përballet me gjyq, në të paktën tri raste penale, gjatë garës së ngushtë për nominimin e kandidatit për president të ShBA-së nga radhët e Partisë Republikane.

Data e gjyqit për rastin e katër penal kundër tij nuk është caktuar ende.

Avokatët e Trumpit kishin bërë trysni që data e gjyqit ndaj tij të caktohej për muajin prill të vitit

2026, shumë kohë pas zgjedhjeve presidenciale të nëntorit 2024, duke argumentuar se kishin nevojë për kohë për t'i rishikuar 12.8 milionë faqe prova që Qeveria i ka grumbulluar.

Por, Chutkan tha se ata nuk kishin nevojë për aq shumë kohë. "Data e propozuar nga mbrojtja për prill 2026 është shumë më tepër seç është e nevojshme", tha ajo.

Gjyqi ndaj Trumpit pritet të fillojë vetëm një ditë para "Super të Martës", kur më shumë se dhjetëra shtete të ShBA-së do t'i mbajnë garat e tyre për nominimin e kandidatit për president.

Ai pritet të dalë në gjyq në Nju Jork më 25 mars nën akuzat për pagimin e një yllit të pornos për ta bërë atë të heshte. Gjyqi i tretë ndaj tij është caktuar për 20 maj 2024 në Florida, ku akuzohet se i kishte



mbajtur jashtëligjëshëm dokumentet e klasifikuara pasi ishte larguar nga Shtëpia e Bardhë, si dhe për pengimin e drejtësisë. Trumpi nuk mori pjesë në seancën dëgjimore të së hënës. Ai e kishte kritikuar gjykatësen Chutkan në të kaluarën, duke

thënë, pa pasur prova, se ajo është e njëanshme ndaj tij.

Chutkan e ka paralajmëruar Trumpin të mos postojë më online deklarata nxitëse rreth dëshmitarëve apo personave të tjerë të përfshirë në këtë rast. Trumpi i ka cilësuar të gjitha katër

rastet penale kundër tij si përpjekje të nxitura politikisht për të mos e lejuar atë të kthehet në pushtet.

Ai u deklarua i pafajshëm në tri prej katër rasteve penale, dhe pritet të dalë para gjykatë në Xhorxhia më 6 shtator për t'u deklaruar për rastin e katërt penal. Edhe ky rast ka të bëjë me përpjekjet e tij për ta zhbërë humbjen e zgjedhjet e vitit 2020.

Në Uashington, avokatët e Trumpit thonë se kanë nevojë për kohë për t'i shikuar provat e Qeverisë. "Liria dhe jeta e këtij njeriu është në pyetje dhe ai meriton përfaqësim të duhur", tha avokati John Lauro.

Prokurorët thonë se shumica e provave përbëjnë materiale publike, si deklarata e Trumpit dhe procesverbalet e Kongresit.

## Amerikanët mendojnë se Bideni është "shumë i moshuar", Trumpi është "i korruptuar"

WASHINGTON, 29 GUSHT - Në një kohë mospajtimesh të thella, votuesit amerikanë pajtohen për një gjë: Presidenti Joe Biden është shumë i moshuar për të qenë efektiv në një mandat të dytë. Ish-Presidenti Donald Trump, kandidati kryesor republikan për president, në mënyrë befasuese nuk nxit shqetësime të ngjashme për moshën e tij, ndonëse ka vetëm disa vjet diferencë mes tyre. Por votuesit kanë shumë shqetësime rreth Trumpit lidhur me aktpaditë penale ndaj tij. Megjithatë ai është 77 vjeç, të anketuarit mendojnë se ish-presidenti duhet të bëhet më i pjekur.

Një anketë e re nga The Associated Press dhe Qendra



NORC, arriti në përfundimin se pjesa më e madhe e publikut është e bashkuar lidhur me moshën e Bidenit, një faktor që ai nuk mund ta ndryshojë.

Presidenti Biden vetë e ka përmendur çështjen e moshës, duke bërë shaka, me sa duket për të qetësuar publikun në këtë drejtim.

Në anketë, 77 për qind të votuesve thanë se Biden është shumë i moshuar për të qenë efektiv në katër vitet e ardhshme. Këtë mendim e ndajnë 89 për qind të votuesve republikanë dhe 69 për qind e votuesve demokratë. Këtë mendim e ndajnë të gjitha grupmoshat, jo vetëm votuesit e rinj, ndonëse demokratët më të moshuar e mbështesin në përgjithësi kandidimin e tij për zgjedhjet e vitit 2024.

Në dallim nga mendimet për moshën e Bidenit, vetëm gati gjysma e amerikanëve e konsideron Trumpin shumë të moshuar për pozitën e presidentit. Por, sa i takon moshës së Trumpit, demokratët dhe

republikanët dallojnë në qëndrime - janë demokratët në përgjithësi që e shohin moshën e Trumpit, si element diskualifikues dhe jo republikanët.

Në përgjithësi, votuesit demokratë, republikanë dhe të pavarurit, janë në favor të vendosjes së një kufiri për moshën e presidentit, anëtarëve të Kongresit dhe atyre të Gjykatës së Lartë. Rreth dy-të-tretat e amerikanëve mbështesin një kufi moshe për presidentin dhe Kongresin, dhe të një moshe të caktuar pensioni për anëtarët e Gjykatës së Lartë.

Anketa supozon se shumë votues janë i gjithë spektri politik, janë të hapur ndaj fytyrave të reja në politikë.

## Iran, shkarkohen 10 profesorë, pasi përkrahën protestat e studentëve

TEHERAN, 29 GUSHT - Autoritetet iraniane i kanë shkarkuar të paktën 10 profesorë universitarë të cilët i kishin mbështetur protestat gjithëkombëtare që nisën shtatorin e kaluar, pas vdekjes së Mahsa Aminit në parburgimin policor.

Pak javë para përvjetorit të vdekjes së saj, Hamideh Khademi dhe Ameneh Aali, dy profesoresha nga Universiteti Allameh në Teheran, u shkarkuan përmes telefonit, derisa Këshilli i Studentëve i Iranit njoftoi se u shkarkuan edhe shtatë profesorë të tjerë nga Fakulteti i Letërsisë në Universitetin e Teheranit.

Universitetet dhe studentët për kohë shumë të gjatë i kanë udhëhequr përpjekjet për liri më të madhe politike dhe shoqërore në Iran. Më 1999, studentët protestuan kundër mbylljes së gazetës së përditshme Reformisti, duke e nxitur një bastisje brutale në konviktet e Universitetit të Teheranit ku mbeti i vdekur një student.

Vdekja e Aminit derisa po mbahej në paraburgim për shkak se e kishte shkelur ligjin për shaminë e kokës në shtator të vitit të kaluar, i ka bërë përsëri kampuset vatër të kundërshtimeve.

Përgjatë viteve, autoritetet i kanë

arrestuar aktivistët studentët dhe liderët, duke i dënuar me burg dhe duke ua ndaluar studimet.

Më 26 gusht, Ali Sharifi Zarchi, anëtar i fakultetit në Departamentin për Inxhinieri Kompjuterike në Universitetin Sharif të Teheranit, shkroi në X, dikur i njohu si Twitter, se e kishte marrë një letër ku njoftohej se ishte shkarkuar nga universiteti.

Gjatë protestave gjithëkombëtare, Zarchi vazhdimisht i përkrahu studentët dhe në një moment deklaroi se do t'i pezullonte të gjitha orët mësimore derisa të gjithë studentët e arrestuar në Universitetin Sharif të liroheshin.



Agjencia e lajmeve Harna thotë se të paktën 700 studentë universitarë janë arrestuar gjatë trazirave të fundit.

Shumica e tyre përballen me

dënime si: burgim dhe rrahje me kamxhik, ndërsa dhjetëra të tjerë janë përjashtuar nga universitetet, apo pezulluar nga studimet.



## Prokuroria e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë së Veriut synojnë rritjen e bashkëpunimit

PRISHTINË, 29 GUSHT - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, ka pritur të martën në takim një delegacion nga Prokuroria për Krim të Organizuar dhe Korrupsion të Maqedonisë së Veriut, i udhëhequr nga kryeprokurori, Islam Abazi. Gjatë këtij takimi është diskutuar për të arriturat dhe sfidat e të dy prokurorive përkatëse, me theks në luftimin e korrupsionit, krimin të

organizuar dhe terrorizmit. Bashkëbiseduesit diskutuan edhe për rishikimin e organizimit të institucioneve, shkëmbimin e përvojave dhe rritjen e bashkëpunimit mes këtyre dy institucioneve me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit në rajon. Kryeprokurori Isufaj të pranishmit i ka njoftuar me punën dhe funksionimin e Prokurorisë Speciale, si dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion në përmbushjen e

misionit të tij. Delegacioni i Prokurorisë për Krim të Organizuar dhe Korrupsion të Maqedonisë së Veriut, është pritur në takim edhe nga u.d. Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, me të cilin kanë biseduar për rritjen e bashkëpunimit mes këtyre dy institucioneve. Të pranishëm në këto takime ishin edhe përfaqësues të Ambasadës Britanike në Prishtinë, të cilët mundëson realizimin e këtyre takimeve.



## Tekstet shkollore, Haradinaj takon Jasharajn: Nuk e kuptoj pafytyrësinë e Kurtit dhe të Nagavci

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se nuk e kupton "pafytyrësinë" e kryeministrit Albin Kurti dhe të ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci, në çështjen e furnizimit të nxënësve me tekste shkollore.

Ai ka thënë të martën pas takimit me kryetarin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, Rahman Jasharaj, se Kurti e Nagavci do të duhej t'i kërkonin falje Kosovës, duke shtuar se prindërit do ta kenë të vështirë furnizimin me tekste për fëmijët e tyre. "Këtu sot kam ardhur me dy qëllime: të mësoj edhe më afër se si është gjendja me këtë situatën me tekstet, për shkak se informatat që i kemi marrë janë mjaft shqetësuese. Për fat të keq, ajo që mësova edhe nga biseda, kemi një situatë jo e mirë. Pra, nga praktika që tekstet do t'i kenë në shkolla, për prindërit tashme do të jetë një luftë e vërtetë për t'i siguruar këto tekste, e përfshihet edhe problemi i kostos. Shumë prindër janë në vështirësi ekonomike. Mund të mos i kenë në prioritet tekstet shkollore. Nuk e kuptoj pafytyrësinë e Kurtit dhe të ministres, të paktën një kërkimfalje Kosovës", ka thënë Haradinaj.

Duke folur për situatën e përgjithshme në vend, Haradinaj ka thënë se kjo qeveri duhet të bie. "Shumë njerëz po i bëjnë thirrje qeverisë tonë të kthehet me aleatët, me Amerikën, me



NATO-n me BE-në, por fatkeqësisht, Kurti dhe kjo qeveri ka zgjedhur një rrugë tjetër. Pasoja po i rriten Kosovës. Parashikimet nuk janë të mira për asnjë temë. Mocioni është mënyra më e duhur, legjitime dhe demokratike. Opozita ka votën sa të iniciojë mocionin, pastaj do të duhej ndihma e deputetëve të tjerë. Shpresoj që në një rrethanë të caktuar do të arrijmë unitetin brenda opozitës. Por po, është opsion", është shprehur Haradinaj. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI) ka dështuar të arrijë pajtim me shtëpitë botuese për tekstet

shkollore dhe ka njoftuar se mjetet për sigurimin e teksteve shkollore do t'uua transferojë prindërve në llogaritë e tyre bankare. Kjo ministri ka hapur platformën e-Kosova për aplikim për subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore nga ana e prindërve, ku pas aplikimit mjetet do të dalin në xhirologaritë e prindërve. Deri më tani janë mbi 50 mijë aplikime në platformën e-Kosova vetëm disa ditë pas lansimit të programit. Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës së Kosovës (SBASHK), Rahman Jasharaj këtë ide e ka

quajtur eksperiment të gabuar. Në takimin me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve, Jasharaj ka theksuar se fatmirësisht ky vit shkollor po fillon pa greva, por me vështirësi shkak i MASHTI-t. MASHTI ka njoftuar se këtë vit shkollor do të sigurojë tekstet e reja për nxënësit e klasave 1-5, ndërsa për nxënësit e klasave 6-9 do të jenë në dispozicion tekstet e vitit paraprak. Për klasat 6-9, tekstet tashmë ndodhen në shkolla, dhe do t'u ndahen nxënësve sapo të fillojë mësimi. Për secilin nga nxënësit filloristë (klasa 1-5), në total do të ndahen nga 80 euro, 50 euro për tekstet

shkollore dhe 30 euro për mjetet mësimore. Ndërsa për nxënësit e arsimit në nivelin e mesëm të ulët (klasat 6-9) të cilët i kanë librat të siguruar nga viti paraprak, do të ndahen nga 30 euro për mjetet mësimore. Partitë opozitare kanë kritikuar ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci, lidhur me planin e ri të shpërndarjes së teksteve shkollore për fëmijët. PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja kanë theksuar se Kosova nuk e meriton një ministere që ka dështuar në çdo nivel ta menaxhojë arsimin dhe përfundimisht është dorëzuar duke ua kaluar përgjegjësinë prindërve.

## Osmani pranoi letrat kredenciale nga ambasadori i ri jorezident i Kuvajtit

PRISHTINË, 29 GUSHT - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pranuar letrat kredenciale nga ambasadori jorezident i Kuvajtit në Kosovë, Faisal Musailleem, të cilin e ka uruar për detyrën dhe ka

shfaqur shpresën se gjatë mandatit të tij do të intensifikohen edhe më tej marrëdhëniet bilaterale në mes të dy vendeve. Në këtë takim, presidentja shtroi nevojën e vazhdimin të mbështetjes edhe në të

ardhmen nga ky shtet. Ndërkaq ambasadori Musailleem, shprehu interesimin për vazhdimin e mbështetjes për Kosovën në fusha të ndryshme dhe u zotua për bashkëpunim më të gjerë në fusha të ndryshme të interesit të përbashkët.







RAUNDI I RI I BISEDIMEVE KOSOVË - SERBI PARASHIHET TË MBAHET NË SHTATOR

## Kurti: Normalizimi i raporteve me Serbinë është i vështirë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se shteti i tij është për normalizimin e raporteve me Serbinë dhe se kjo është e mundur pavarësisht se është një proces i vështirë, por homologia e tij serbe, Ana Bërnabiq, ka theksuar se prioritet për Beogradin është themelimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Këto komente të dy i bënë gjatë një diskutimi të udhëheqësve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në hapje të Forumit të Bledit në Slloveni

**EPOKA E RE** Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 29 GUSHT** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se qeveria e tij është e përkushtuar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, por procesi po vështirësohet nga veprimet e Beogradit zyrtar.

Ai i bëri këto komente gjatë një diskutimi të udhëheqësve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në hapje të Forumit të Bledit në Slloveni. "Dua t'i normalizojmë

marrëdhëniet dhe do ta bëja menjëherë një gjë të tillë nëse për shembull fqinji im do të ishte Republika Çeke, por normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë është shumë më i vështirë. Mund të ndodhë, sepse ne duhet ta zbatojmë marrëveshjen bazë për të cilën unë dhe presidenti serb jemi pajtuar në Bruksel, por normalizim në psikologji do të thotë mungesë e ngatërrimit të realitetit me fantazinë e ky është një aspekt tjetër në të cilin unë nuk mund të ndihmoj", ka theksuar kryeministri Kurti,

duke iu referuar deklaratës së kryeministres së Serbisë, Ana Bërnabiq e cila tha gjatë fjalimit të saj se Serbia dhe Kosova janë një shtet.

Bërnabiq theksoi se nuk mund të ketë normalizim të marrëdhënieve pa zbatim të marrëveshjes së vitit 2013 ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe. "Normalizimi nis me Marrëveshjen e Brukselit, të nënshkruar në prill të vitit 2013, si marrëveshje e parë për normalizim midis

Beogradit dhe Prishtinës, të cilën e kanë nënshkruar edhe zyrtarët e BE-së. E vetmja gjë që Prishtina duhej të bënte në bazë të Marrëveshjes së parë të Brukselit, ishte themelimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Pothuajse 11 vjet më vonë, ky Asociacion nuk është themeluar. Dhe zoti Kurti thotë se Marrëveshja e Brukselit nuk ekziston për të. Dua t'ua rikujtoj, ajo ka qenë marrëveshja e parë e normalizimit të raporteve dhe duhet të zbatohet. BE-ja është garantuesja për zbatimin e plotë të asaj marrëveshjeje. Ajo që po presim është Asociacioni", ka thënë ajo, duke theksuar se themelimi i tij do të hapte rrugën që Serbia të ndërmarrë hapa pozitiv drejt shtensionimit të plotë të situatës në veri të Kosovës. Kryeministri Kurti ka pohuar se Kosova tashmë ka dëshmuar përkushtimin e saj për

shtensionimin e plotë të gjendjes në zonën e banuar me shumicë serbe, duke përgjysmuar praninë e njësive të policisë në ndërtesat komunale në veri dhe duke bërë veprime për t'u hapur rrugë zgjedhjeve të parakohshme.

**Kurti e Lajçaku bisedojnë për raundin e ri të dialogut**

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka biseduar me të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, për raundin e ri të bisedimeve të nivelit të lartë, që parashihet të mbahet në shtator.

Kurti dhe Lajçak u takuan në margjinat e Forumit Strategjik të Bledit, që po mbahet në Slloveni. "Kisha një takim të rëndësishëm me kryeministrin

## Lëvizja Vetëvendosje vlerëson bashkëpunimin me FES-in

**PRISHTINË, 29 GUSHT** - Sekretari i Lëvizjes Vetëvendosje për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Hajrulla Çeku, ka pritur të martën në takim drejtorin aktual të FES-it në Kosovë, Rene Schlee, i cili ishte i

shoqëruar nga Peter Hurrelbrink, që pritet ta zëvendësojë Schleen në këtë pozitë.

Sipas njoftimit të LV-së, në këtë takim u diskutua rreth bashkëpunimit që LV-ja kishte

gjatë viteve të fundit me Schleen, ku edhe shprehen një falënderim të veçantë për punën e tij, njëherazi duke i uruar sukses të mëtutjeshëm në angazhimet e tij të reja. "Dhe, duke i uruar

mirëseardhje në Kosovë z. Hurrelbrink, ndamë bindjen e përbashkët për vazhdimin e bashkëpunimit përmes FES-it, të cilën organizatë e kemi edhe partner socialdemokrat", ka njoftuar LV-ja.





# Paralajmërimi i Macronit për vizat, Shasha: Mos merrni seriozisht asgjë derisa nuk dëgjoni Komisionin Evropian

PRISHTINË, 29 GUSHT - Të hënën presidenti i Francës, Emmanuel Macron në një fjalim para ambasadorëve paralajmëroi masa nëse Kosova dhe Serbia nuk rregullojnë marrëdhëniet mes tyre.

E ky qëndrim i presidentit të Francës, ka alarmuar partitë opozitare në Kosovë të cilat kanë kërkuar nga kryeministri Albin Kurti, që të mos e rrezikojë lirinë e lëvizjes së qytetarëve.

Në lidhje me këtë drejtori i

Institutit EPIK, Demush Shasha ka thënë se nuk duhet marrë asnjë deklaratë seriozisht deri sa nuk thuhet nga Komisioni Evropian. "Pezullimi i liberalizimit të vizave është akt ekstrem që merret në raste ekstreme. Për shembull Rusisë iu pezullua vetëm pasi që pushtoj Ukrainën. Vanautusë iu pezullua vetëm pasi që refuzoj me kokëfortësi të ndal skemën e 'pasaportave të arta'. Serbisë nuk iu pezullua liberalizimi

përkundër që u shndërrua në portën kryesore të migrimit ilegal në BE. Çfarë dua të them është se standardi i pezullimit të liberalizimit të vizave është shumë - shumë i lartë. Ne sot jemi shumë larg këtij standardi. Nga ana tjetër presidenti Macron nuk ka thënë asgjë të re. Konteksti i fjalimit të tij ka të bëjë me sigurinë e Ballkanit. Ky ishte fjalimi vjetor para ambasadorëve francez në botë dhe fjalimi ishte fokusuar në

pikat neurologjike të botës. Rrjedhimisht ai aty flet 10 sekonda për Ballkanin dhe vetëm në kuptimin e gjësë më të rëndësishme: sigurisë, stabilitetit dhe paqes. Prandaj ai paralajmëron se në raste ekstreme të kërcënimit të sigurisë në Ballkan, patjetër që edhe liberalizimi i vizave mund të pezullohet. Kjo nuk është risi. Por ne sot jemi shumë larg këtij skenari, prandaj përderisa plotësisht mirëkuptoj ankthin

që kemi nga kjo puna e vizave duhet të flemë qetë duke ditur se asgjë në BE nuk ka ndryshuar sa i përket kësaj çështje", ka shkruar Shasha në "Facebook". Ai ka thënë se për të rregullit i artë sa i përket pezullimit të liberalizimit të vizave është ky: "mos merrni seriozisht asgjë derisa nuk dëgjoni Komisionin Evropian duke folur për të. Deri atëherë çdo gjë që dëgjoni është pjesë normale e lojërave dhe negociatave politike".



Kurti sot në Bled. Çështja kryesore e takimit ishin përgatitjet e takimit të ri të nivelit të lartë në dialogu në shtator, me fokus në normalizimin e raporteve dhe zbatimin e marrëveshjes së 3 qershorit", ka shkruar Lajçak në "X", që më herët njihej si "Tëitter".

Deklarata e 3 qershorit e liderëve të Bashkimit Evropian ka të bëjë me kërkesat kyçe të bllokut evropian për Kosovën dhe Serbinë, lidhur me uljen e tensioneve në veri të Kosovës dhe rikthimin e palëve në dialog.

Për shkak të mospërmbushjes së kërkesave, BE-ja ka vendosur disa masa ndëshkuese ndaj Kosovës, të cilat janë ende në fuqi.

Sa i përket situatës në veri të Kosovës, të banuar me shumicë serbe, Kurti, sipas një njoftimi të zyrës së tij, tha se situata tashmë është shtensionuar dhe

ajo "nuk duhet të përshkallëzohet sërish". "Kosova tashmë është duke punuar në legjislacionin dytësor për zgjedhjet e hershme të cilave duhet t'iu prijë një kampanjë e hapur, pa frikësime dhe shantazhe e pasuar me zgjedhje të lira e demokratike", tha Kurti, sipas njoftimit për media.

Situata në veri të Kosovës u tensionua në fund të majit, pasi kryetarët e rinj shqiptarë - të Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit - me asistimin e policisë hynë në ndërtesat komunale.

Serbët lokalë kundërshtojnë kryetarët e rinj shqiptarë, që u zgjodhën në zgjedhjet e prillit. Ky proces ishte bojkotuar nga popullata serbe dhe partitë serbe.

Në korrik, Kosova dhe BE-ja u pajtuan për hapat drejt shtensionimit, përfshirë edhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja në katër komunat në veri.



## Dogana konfiskon një sasi të barnave të kontrabanduara nga Shqipëria dhe Serbia


PRISHTINË, 29 GUSHT - Në Regjionin e Prishtinës, Dogana e Kosovës, e përkrahur nga Policia e Kosovës, ka ndaluar një automjet të dyshuar. Në

këtë rast është zbuluar një sasi e konsiderueshme barnash të kontrabanduara nga Shqipëria dhe Serbia. Mallrat e kontrabanduara janë konfiskuar dhe

procedurat ligjore kundër personave të përfshirë në këtë kundërvaje kanë filluar.

Dogana e Kosovës ka njoftuar se së bashku me

agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, vazhdon të jetë e përkushtuar në luftën kundër krimit dhe në ruajtjen e shëndetit të popullsisë.





## Voziti në kahje të kundërt të autostradës, gjobitet 300 euro dhe i ndalohet drejtimi i mjetit për një vit

PRISHTINË, 29 GUSHT - Njësia për Kontroll të Autostradave gjatë patrullimit në segmentin e autostradës

Veternik - Bresje ka hasur në mjetin i cili ishte duke lëvizur në kahje të kundërt, i njëjti është gjobitur me

300 euro, 3 pikë negative dhe 1 vit i është ndaluar drejtimi i mjetit me veprim motorik.



## Njësia e Pylltarisë në Gjilan pranon 450 kërkesa për prerje legale të druve në pronësi private

GJILAN, 29 GUSHT - Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Gjilan, në kuadër të planeve vjetore operationale të menaxhimit me pyje sipas standardeve të punës, ka paraparë edhe aksione të përbashkëta me Drejtorinë Rajonale të Policisë së Kosovës për parandalimin e prerjes ilegale të pyjeve.

Falë bashkëpunimit të mirë me komandantin e Stacionit Policor në Gjilan, majorin Agim Lipovica dhe drejtorit të Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bajram Isufi, përkatësisht Sektorit të Pylltarisë në Gjilan, është ndërmarrë aksioni për parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve.

Pasi gradualisht po afrohet stina e dimrit, shumë persona recidivistë, prerës ilegalë në mënyrë të pandërgjegjshme me qëllim të përfitimit individual angazhohen në prerje ilegale të pyjeve shtetërore dhe private.



Për këtë arsye, Drejtoria e Bujqësisë - Sektori i Pylltarisë ka filluar aksionin me asistencën e policisë së Kosovës për kapjen e prerësve ilegalë.

Në këtë aksion janë ndaluar mbi

120 kamioneta e traktorë të cilat kanë qenë të pajisura me dokumentacionin të rregullt për prerje legale dhe të kontrolluar. Gjatë aksionit, policia dhe pylltarët kanë hasur edhe në

prerës ilegalë me ç'rast janë konfiskuar një masë e konsiderueshme e masës drusore si dhe do të bëhen edhe fletëparaqitje për kundërvajtje dhe vepra penale.

Njësia e Pylltarisë këtë vit ka pranuar mbi 450 kërkesa për prerje legale të druve në pronësi private, si rezultat i ngritjes së vetëdijes tek qytetarët se vetëm me leje adekuate dhe të kontrolluar mund të pajisen me masën drusore.

Gjatë kontrolleve rutine ekipet në teren kanë hasur edhe kamionetë dhe automjete të tipit 'pikap' të ndryshme të pa regjistruara ku janë marrë masat ndëshkimore, deri te konfiskimi i automjeteve.

Gjatë aksionit janë kontrolluar edhe pikat legale të shitjes së masës drusore ku është verifikuar edhe dokumentacioni përcjellës, drutë e damkosura dhe ato të pa damkosura.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, në koordinim me Policinë e Kosovës kanë rënë dakord për ndërmarrjen e aksioneve më të shpeshta për parandalimin e prerjeve ilegale.

## U hap festivali "Mitrovica International Jazz Days"

MITROVICË, 29 GUSHT - Është hapur festivali "Mitrovica International Jazz Days", një ngjarje muzikore e shumëpritur në qytetin e Mitrovicës.

Organizuar nga këngëtarja dhe producentja Rona Nishliu, festival ky që rrethonte veten me një atmosferë të magjshme të tingujve të jazz-it.

Në hapjen zyrtare, ishin të pranishëm, kryetari i komunës, Bedri Hamza, nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, kryesuesja e KK-së, Vesa Broja, drejtoresha e DKRS-së, Valdete

Idrizi, ambasadori i ShBA-së, Jeffrey M. Hovenier, zv/ambasadori Italian në Kosovë, Ugo Ferrero, përfaqësues të Unionit të Bashkive dhe shumë qytetarë.

Artisti ndërkombëtar Richard Bona përcjellur nga një grup muzikantësh të jashtëzakonshëm nga Kosova dhe rajoni, sollën në skenë një përzierje të tingujve të tij me ndjenjën autentike të zhanrit jazz.

Me notat e tij melodike dhe improvizimet e shkëlqyera, Bona bëri që publiku të ndihet pjesë e

një përvoje muzikore të jashtëzakonshme.

Kombinimi i artistëve ndërkombëtarë dhe lokalë krijoi një atmosferë të jashtëzakonshme, ku muzika dhe kultura u bashkuan për të krijuar një ngjarje që do të kujtohet për një kohë të gjatë.

Hapja e festivalit "Mitrovica International Jazz Days" u bë një shenjë e fuqishme e potencialit të qytetit për të mbajtur ngjarje të nivelit ndërkombëtar dhe për të promovuar artin dhe kulturën e Kosovës.



## Përurohet Qendra "One Stop Shop" në Mitrovicë



MITROVICË, 29 GUSHT - Është përuar hapja e Qendrës së Integruar "One Stop Shop" në Komunën e Mitrovicës për ofrimin e shërbimeve më efikase për qytetarët në fushën e administratës komunale.

Në këtë ceremoni mori pjesë edhe kryetari i Komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, dhe zyrtarë të tjerë komunalë për të

shënuar fillimin e këtij inovacioni të rëndësishëm.

Në fjalën e tij, kryetari Hamza ka thënë se ashtu siç ka premtuar, qytetari është në qendër të qeverisjes së tij, ku tashmë qytetarët do të marrin shërbime komunale pa pritje të gjata dhe me transparencë të plotë.

Ai më tutje ka shtuar se edhe zyrtarët e komunës tani do të

kenë një ambient të përshtatshëm për punë dhe do të jenë më të motivuar për të ofruar shërbime efikase.

Hapja e Qendrës së Integruar "One Stop Shop" në katin e parë të Administratës Komunale, do të mundësojë që të ofrohen shërbime të shumta me standarde të larta, në një ambient modern e të digjitalizuar.

## Vazhdojnë punimet në rregullimin e "Xhepit Urban" në lagjen "Arbëria"

PRISHTINË, 29 GUSHT - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se janë duke vazhduar me rregullimin e "Xhepit Urban" në lagjen "Arbëria", e cila përmes shkallëve do të

lidhë rrugën "Vicianum" me atë "Ahmet Krasniqi" "Në një sipërfaqe prej 1,093 m<sup>2</sup> do të krijohet një park, shtigje e pushimore për këmbësorë", ka njoftuar Rama.

Ai së bashku me të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Japonisë, Keisuke Yamanaka, vizituan punimet të cilat janë duke u bërë në realizimin e këtij projekti.





## Nënshkruhet memorandumi për digjitalizimin e sistemit noterial

PRISHTINË, 29 GUSHT - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi edhe me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, duke përmbyllur ciklin e nënshkrimit të memorandumeve të bashkëpunimit me ministritë tjera për digjitalizimin e sistemit noterial.

Ky memorandum i bashkëpunimit, i cili ka për

qëllim mundësimin e qasjes së noterëve në të dhënat e Sistemit e Informatave Kadastrale për Tokën në Kosovë që mirëmbahet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës mundëson përcaktimin e procedurave për shkëmbimin e të dhënave, përcaktimin e rregullave të sigurisë, procedurave përkatëse për qasje dhe përdorim të të dhënave, si dhe krijimin e lehtësirave të nevojshme administrative për

bashkëpunim ndërinstitucional në mes të institucioneve respektive me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimit të noterisë.

Përmes kësaj platforme mundësohet harmonizimi i të gjitha procedurave të brendshme në një sistem të centralizuar e të ndërlidhur që mundëson për noterët qasje më të lehtë në shërbime, informata të sakta e të verifikuara në kohë reale.



## KE-ja thotë se fokusohet në zgjerim dhe jo në afate kohore



PRISHTINË, 29 GUSHT - Komisioni Evropian (KE) nuk është i përqendruar në afate kohore në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian (BE), por për t'i ndihmuar vendet kandidate për të përparuar në këtë proces, tha të martën zëdhënësja e KE-së, Dana Spinat.

Spinat i bëri këto komente në një konferencë për shtyp në Bruksel më 29 gusht, pas propozimit të presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel, që viti 2030 të caktohet si afat deri kur vendet e tashme kandidate dhe BE-ja të jenë të gatshme për zgjerim.

Por, derisa e pranoi se zgjerimi është prioritet politik për

Komisionin Evropian, ajo iu përgjigj Michelit duke thënë se "nuk jemi të fokusuar në afate kohore, por t'i ndihmuar kandidatët në përmbushjen e kriterëve dhe për t'u bërë gati". "Presidentja [e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen] në mënyrë specifike ka thënë se sa të përkushtuar jemi ne që ta bëjmë të suksesshëm zgjerimin. Gjithmonë kemi thënë se zgjerimi është prioritet dhe kandidatët duhet të anëtarësohen kur të jenë gati. Kemi punuar për së afërmi me kandidatët për t'i ndihmuar që ata të kryejnë reformat", tha Spinat.

Ajo shtoi se ky proces duhet të mbetet proces i bazuar në merita dhe se kandidatët duhet të lëvizin në përputhje me suksesin e tyre në përmbushjen e kriterëve.

Zëdhënësja e Komisionit Evropian ka përsëritur se suksesi në zgjerim kërkon që edhe kandidatët edhe BE-ja të bëhen gati. Ajo ka paralajmëruar se liderët e BE-së do të diskutojnë për zgjerimin në samitin e Granadës në Spanjë, më 5 tetor 2023. "Kemi instrumente për t'i ndihmuar kandidatët për t'u afruar me BE-në edhe para se të bëhen anëtare. Komisioni ka dëshmuar se është i përkushtuar që ta mbajë procesin e zgjerimit

si prioritet", theksoi ajo.

Spinat tha se "nuk është në dijeni se ka pasur kontakte mes Michelit dhe Ursula von der Leyen për këtë çështje", para se Michel të dilte me propozimin e tij.

Më 28 gusht, Michel bëri thirrje që viti 2030 të caktohet si afati deri kur Bashkimi Evropian dhe vendet kandidate të jenë të gatshëm për zgjerim.

Gjatë fjalimit në Forumin Strategjik të Bledit, ai përsëriti disa herë se tash e tutje vendeve kandidate duhet referuar si "vende të ardhshme anëtare të BE-së".

Në Forumin e Bledit në Sloveni

morën pjesë liderët e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, por edhe liderë të disa shteteve të BE-së.

Michel e pranoi se rruga e gjatë e shteteve të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së, që ka nisur para më shumë se 20 vjetësh, ka shkaktuar zhgënjim te shumë njerëz, si në rajon, ashtu edhe në bllokun evropian.

Zgjerimi i fundit i BE-së ka ndodhur me 1 korrik të vitit 2013 kur Kroacia ishte bërë vendi më i ri anëtarë. Prej atëherë nuk ka pasur zgjerim ndërsa Britania e Madhe është larguar nga BE-ja duke e lënë atë përsëri me 27 vende anëtare.

## Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë uron Maqedoncin për emërimin në postin e ministrit të Mbrojtjes

Prishtinë, 29 gusht- Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Niko Peleshi, ka uruar ministrin e Mbrojtjes së Kosovës, Ejup Maqedonci për emërimin e tij si ministër.

Në letrën e ministrit Peleshi rikonfirmohet se Ministria e Mbrojtjes e Republikës së

Shqipërisë do të vazhdojë angazhimin e plotë për mbështetje dhe përkrahje të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së në rrugën e transformimit, modernizimit dhe integritimit në strukturat Euro-Atlantike.

Ndërsa shpreh bindjen se

bashkëpunimi i shkëlqyer bazuar në miqësinë e ndërsjellë dhe mirëkuptimin ndërmjet dy institucioneve tona do të vazhdojë me të njëjtin ritëm dhe përkushtim, me qëllim realizmin e projekteve tona të përbashkëta.





Reagim i KMDLNj-së

# Ndërtimtaria, sektori ku më së shumti rrezikohet jeta e punëtorëve!

Në Kosovë nuk paraqet lajm nëse ndonjë punëtor lëndohet, bëhet i paafte përjetësisht për punë apo edhe e humb jetën për faktin se punëdhënësi nuk siguron kushte për punë për të punësuarit, nuk kanë kontrata pune, nuk kanë sigurime shëndetësore e mos të flasim për sigurime të jetës. Për fat të keq disa raste përfundojnë me lëndime të rënda dhe të pariparueshme kurse në raste të tjera edhe me fatalitet. Për shtatë muaj të vitit 2023, në vendet e tyre të punës kryesisht në sektorin e ndërtimit kanë humbur jetën 18 punëtorë e që paraqet edhe një numër rekord të pësimeve me fatalitet për jetën. Për shkak të kushteve të rënda ekonomike shumë punëtorë, ndonjëse të pakualifikuar për punën që e bëjnë detyrohen që të punojnë në kushte skajshmërisht të rrezikshme për jetën, pa pasur fare siguri dhe pa u kompensuar familjet për humbje të jetës.

Nëse kemi parasysh faktin se Kosova në përgjithësi, kurse Prishtina në veçanti janë shndërruar në kantierë ndërtimi ku punohet pa orar, në ditë feste, ditë pushimi, në kushte të rënda atmosferike dhe, madje punohet edhe gjatë natës pa pasur aspak konsideratë për sigurinë dhe qetësinë e qytetarëve, pa mbikëqyrje efektive të institucioneve përgjegjëse atëherë edhe kemi një numër aq të madh të viktimave në vend të punës. Trafiku është shndërruar në kaos ku



kamionët e shumë me dhe materiale inerte, cisternat me betone dhe mekanizmi ndërtues i rëndë, qarkullojnë nëpër rrugët e kryeqytetit, pa një orar të caktuar dhe pa kufizime drejtimesh kah mund të lëvizin. Jo rrallë kemi raste kur nga kamionët derdhet dheu apo materiali inert apo kur nga gypi i betonjerkës rrjedhë betoni që, përveç se e ndotin rrugën, në shumë raste edhe e dëmtojnë! Për KMDLNj-në është brengosëse humbja e jetës të punëtorëve, e në disa raste në mesin e të cilëve ka persona të mitur. Inspektorati i Punës së Kosovës nuk ka kapacitet t'i mbulojë të gjitha vendpunimet për shkak se numri i inspektorëve është në

shpërputhje të madhe me kërkesat për inspektim dhe, pa asnjë dyshim duket se mungon vullneti institucional për përmirësimin e gjendjes. KMDLNj ka kërkuar dhe e përsërit se duhet t'u hiqet leja e punës për punëdhënësit që nuk sigurojnë kushte për punë me ç'rast rrezikohet jeta e të punësuarve. Gjithashtu, KMDLNj ka kërkuar që dënimet në të holla të jenë shumë më të larta dhe nga ato mjete të grumbulluara të krijohet një Fond për ata që e pësojnë dhe familjet e tyre. Është e pabesueshme që edhe pas të gjitha jetëve të humbura për shkak të kushteve të punës, askush të mos ketë përgjegjësi para ligjit. Shteti duhet të gjejë një mënyrë që familjet që e

humbin anëtarin e familjes duhet të kompensohen dhe ta kenë një pension, jo më të vogël se paga e një të punësuarit në ndërtimtarin. Ose duhet të ashpërsojë gjobat në rast të humbjes së jetëve apo lëndimeve, ose duhet të rrisë taksat për leje ndërtimi e që një pjesë do të derdheshin në Fondin e viktimave të ndërtimitarisë por edhe në vendet e tjera të punës e ku përgjegjësia është e punëdhënësit. Numri i lartë i vdekjeve dhe rasteve që kanë pësuar lëndime në vendin e punës, 18 të vdekur janë dëshmi që gjendja në këtë sektor nuk është përmirësuar fare dhe është alarmi i fundit për veprim dhe masa konkrete. KMDLNj

vlërëson se, nëse nuk ndërmerren masat parandaluese për sigurimin e kushteve të mira për punë, humbja e jetëve do të vazhdojë kurse, të gjithë ne që e kemi një përgjegjësi, do të merremi me reagime gjykuese dhe me pasoja, që do të jenë shumë më të rënda nëse kemi parasysh që kantieret e ndërtimit kanë metastazuar dhe janë shtrirë pothuajse në çdo pjesë të Kosovës. Në mungesë të kapacitetit të mjaftueshëm të Inspektoratit të Punës për të mbuluar të gjitha vendndërtimet, KMDLNj propozon që vrojtuesit e lagjeve të sinjalizojnë te autoritetet përgjegjëse në rast se mungojnë masat mbrojtëse për punëtorët. Gjithashtu edhe Policia e Kosovës gjatë patrullimeve mund të identifikojë raste të shkeljeve të kushteve të punës. Është gjithashtu edhe detyrim qytetar që të lajmërojnë këto raste e që mund të ndikojnë shumë në uljen e pasojave në vend të punës. Me largimin e punëtorëve drejt vendeve me kushte më të mira të punës si dhe me paga më të larta, KMDLNj ka frikë se numri i viktimave vetëm sa do të rritet, sa për shkak të mungesës së kualifikimit ashtu edhe shkak i moshës. Këto vdekje duhet të trokasin në ndërgjegjen e politikanëve dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës në mënyrë që të përmirësohen kushtet e punës e që nënkupton edhe rritjen e sigurisë për të punësuarit. Në të kundërtën askush nuk do të falet nga përgjegjësia!

## Kosova në forumin strategjik të Bledit, temë diskutimi edhe sektori TIK-ut

PRISHTINË, 29 GUSHT - Zëvendësministri i Ekonomisë së Kosovës, Getoar Mjeku ka zhvilluar takim dypalësh ministren e Transformimit Digjital të Republikës së Sllovenisë, Emilija Stojmenova, në kuadër të konferencës "Forumi Strategjik i Bledit 2023". Në takim, zëvendësministri Mjeku është shoqëruar edhe nga këshilltari i kryeministrit Kurti për sektorin e TIK-ut, Lulëzon Jagxhiu. Gjatë takimit ministrja Stojmenova e ka përgëzuar zëvendësministrin Mjeku për arritjen e Republikës së Kosovës në mbulueshmëri të 100% të zonave me internet të shpejtë, duke e cilësuar këtë arritje si shumë mbresëlënëse. Ajo e njoftoi zëvendësministrin Mjeku që Sllovenia është aktualisht duke punuar në të njëjtin drejtim dhe synojnë që ta

arrijnë këtë deri në vitin 2030. Për më shumë ajo ka përgëzuar Republikën e Kosovës për përqindjen e madhe të vajzave në sektorin e TIK-ut, që në nivel universitar është mbi 50%. Tutje është diskutuar për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm mes dy vendeve, në përgjithësi, mirëpo edhe në sektorin e TIK-ut në veçanti, ku Sllovenia është partnere e Kosovës. Palët kanë folur rreth zhvillimit e aftësimin të fuqisë punëtore, zhvillimit të Parkut të Inovacionit dhe Teknologjisë, si dhe hovit të zhvillimit të sektorit privat të TIK-ut në të dy vendet. Po ashtu, është diskutuar për përpjekjet e të dy vendeve për të centralizuar digjitalizimin e shërbimeve publike si dhe lehtësimin e qasjes në to për të gjithë qytetarët, aspekt horizontal në të gjitha sektorët.





# Bill Gates, sekretet e suksesit



**Nga Rainer ZITELMANN**

Unë e kam ndjekur jetën e Bill Gejtsit në dekadat e fundit. Në vitin 1992, si drejtor i "Ullstein Verlag", botova biografinë e parë të miliardërit amerikan në Gjermani. Autorët e librit ishin Xhejms Uollas dhe Xhim Erikson, dhe në atë kohë vështirë se dikush në Gjermani kishte dëgjuar për Bill Gejtsin. Prandaj, vendosa që t'i vendos titullin "Zoti Microsoft". Tek e fundit, njerëzit e njohnin emrin e kompanisë dhe jo njeriun që e drejtonte atë. Ndërkohë sot gati të gjithë kanë dëgjuar ndoshta për Bill Gejts.

Në fillim të korrikut 1991, Bill Gejts Senior (Plaku) kishte disa të ftuar për darkë në shtëpinë e tij. Midis tyre ishte djali i tij, themeluesi i kompanisë "Microsoft", dhe Uorren Bafet – dy nga burrat më të suksesshëm në botë, të cilët për shumë vite kanë alternuar njëri-tjetrin në krye të listës së miliardërve të revistës "Forbes".

Në një moment i zoti i shtëpisë i pyeti mysafirët e tij: "Cili është sekretet i suksesit tuaj?". Bafet u përgjigj menjëherë: "Përqendrimi!". Bill Gejts Xhuniore dha të njëjtën përgjigje.

Qëkur ishte i ri, Bill Gejts nuk ishte një person i lehtë për t'u menaxhuar.

Ai shkonte shumë mirë me mësimet në shkollë, sidomos në matematikë, por ishte i njohur për sjelljen e tij "të ashpër dhe sfiduese" ndaj mësuesve të tij. Për shembull, në shkollën e mesme ai pati një debat të fortë me mësuesin e tij të fizikës. Gejts po ngrinte zërin në kupë të qiellit, duke tundur gishtin dhe duke i thënë mësuesit të tij se e kishte gabim për një problem të

fizikës dhe nxënësi po e fitonte debatin me mësuesin.

Fiksimi i Billit pas kompjuterëve filloi që në moshën 13 vjeçare. Aq sa prindërit e tij ishin të shqetësuar për të. Edhe pse ishte vetëm në vitin e parë të gjimnazit, ai tashmë dukej i fiksuar pas kompjuterëve, duke injoruar gjithçka tjetër. Në këto kushte ata e ndaluan të prekte kompjuterin për 9 muaj.

Përplasjet e vazhdueshme të Bill Gejts me prindërit e tij arritën kulmin kur ai vendosi të braktiste Universitetin e Harvardit. Bill u tha prindërve se kishte shkuar në Harvard me shpresën se atje do të takonte njerëz me nivel intelektual më të lartë se ai, por nuk kishte gjetur dot të tillë.

Prandaj ai vendosi mirë të transferohej në Albuquerk në Nju Meksiko, për të themeluar kompaninë e tij. Prindërit e tij u përpoqën shumë që ta bindnin të hiqte dorë nga kjo ide që për ta ishte absurde. Ata i kërkuan një biznesmeni të suksesshëm dhe njëherazi mik i familjes, që të bisedonte me djalin e tyre, për ta rikthyer më këmbë në tokë.

Gjatë takimit mes të dyve, Gejts i tregoi biznesmenit planet e tij dhe i foli gjerë e gjatë për revolucionin në informatikë, për të cilin ai mendonte se ishte shumë pranë. Një ditë të gjithë do të kenë një kompjuter personal në shtëpi, i tha Gejts.

Pasi e dëgjoi biznesmeni që duhej ta bindte Billin të hiqte dorë nga planet e tij, përfundoi duke e mbështetur atë. Prindërit e tij u tronditën kur ai u largua nga universiteti për të themeluar "Microsoft", kompaninë që do ta bënte atë njeriun më të pasur në botë.

Sipas shokut të tij të dhomës në

universitet "Bill kishte një cilësi të rrallë. Ai përqendrohej tek diçka dhe bëhej plotësisht i lidhur me të. Ai kishte vendosmërinë të zotëronte çdo gjë që bënte". Edhe një nga ish-të dashurat e Gejts ka folur për fokusin e tij të vazhdueshëm tek objektivat dhe urrejtjen që kishte ndaj gjërave që e shpërqendronin.

Ai nuk kishte televizor në shtëpi, madje kishte hequr edhe kasetofonin e makinës: "Tek e fundit, ishte shumë e vështirë të mbaje një marrëdhënie me dikë me të cilin mund të kaloje vetëm një kohë të shkurtër, nga momenti i largimit nga zyra në "Microsoft" deri në atë të rikthimit në punë mëngjesin tjetër ishin vetëm 7 orë" - kujton njëra prej tyre.

Ndërkohë Gejts ishte një shef i ashpër, një tipar karakterial që ai e ndan me shumë njerëz të suksesshëm. Në shumë aspekte ai ishte tërësisht e kundërta e drejtuesve për të cilët flitej në librat që jepnin leksione mbi leadershipin. Ai ishte i njohur për dërgimin e-maileve punonjësveve të tij edhe në mes të natës (më shpesh kur ata ishin ende në punë).

Një e-mail tipik i tij fillonte kështu: "Kjo është pjesa më idiote e kodit e shkruar ndonjëherë". Punonjësit e tij u referoheshin këtyre mesazheve si "e-maile të zjarrtë". Ashtu si shumë shefa, Gejts ishte shpesh i paduruar, dhe e shprehte shpeshherë këtë gjë në mënyra që të tjerët i konsideronin fyese.

Një ish-menaxher i "Microsoft", kujton se Gejts i shkoi në zyrë që javën e tij të parë në kompani dhe i ulëriti "Si mund të harxhosh kaq kohë duke punuar mbi këtë kontratë? Vetëm bëje!". Ndërsa nuk ishte aspak e lehtë për t'u marrë

vesh me të, punonjësit e tij e vlerësonin faktin që Gejts ishte gjithnjë i vetëdijshëm për punën që po bënin.

Siç vuri në dukje një ish-punonjës: "Shumë njerëz nuk e pëlqejnë punën që bëjnë, pasi nuk marrin asnjë reagim pozitiv apo vlerësim. Ky problem nuk ekzistonte këtu. Ti e dije saktësisht se çfarë mendonte Billi për punën që po bëje". Sigurisht, anekdotat për karakterin nevrastenik të Gejts tregojnë vetëm njërin anë të historisë.

Ai e dinte më mirë se sa çdo sipërmarrës tjetër se si ta stimulonte dhe motivonte stafin e tij, për të arritur një qëllim të përbashkët. Askush nuk mund të arrijë një ecuri kaq të shkëlqyer nga punonjësit vetëm duke u bërë presion atyre. Edhe pse Gejts ishte i njohur për qëndrimin e tij agresiv ndaj të tjerëve, ai dinte t'i inkurajonte bashkëpunëtorët e tij, duke u dhënë atyre shumë liri krijuese.

Fryma pioniere dhe gjallëria frymëzuese e "Microsoft", kanë tërhequr shumë të rinj të zgjuar dhe ambiciozë. Pasi i ka arritur të gjitha me kompaninë e tij, Billi i ka vendosur vetes synime të reja dhe më të mëdha. Ai ka dashur gjithmonë që t'andryshojë për mirë botën, duke iu përkushtuar luftës kundër sëmundjeve.

Në vitin 1994 ai krijoi një fondacion, i cilinë vitin 1999 mori emrin Fondacioni Bill & Melinda Gejst. Ai është fondacioni më i madh privat në botë, me një aset prej afro 50 miliardë dollarësh. Që nga fillimi i këtij fondacioni, çifti Gejts ka shpenzuar gati 55 miliardë dollarë për bamirësi.

Projektet e fondacionit kryesisht kanë në fokus vendet në zhvillim,

ku ai po mbështet përpjekjet për të luftuar sëmundje të tilla si malaria dhe poliomieli. Në qershor të vitit 2010 Bill Gejts ndërmori fushatën "Giving Pledge", së bashku me njerëz të tjerë, përfshirë mikun e tij Uorren Bafet.

Miliarderët që e mbështetën atë nismë kanë premtuar të dhurojnë të paktën gjysmën e pasurisë së tyre për bamirësi. Gejts është vendosur në qendër të shënjestrës së teoricienëve të konspiracionit, të cilët vënë në pikëpyetje gjithçka që ai bën, dhe madje e fajësojnë atë si sponsorin më të madh privat të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH). Pesë vjet para shpërthimit të Covid-19, ai bëri një paralajmërim të qartë: një virus shumë infektues mund të vriste një numër të madh njerëzish në të ardhmen e afërt. Kritikët e tij i kanë shtrembëruar këto fjalë kundër tij, duke e akuzuar atë për përhapjen e koronavirusit nëpër botë, në mënyrë që të ishte në gjendje të vaksinonte njerëzit dhe të fuste fshehurazi çipa në trupat e tyre për t'i kontrolluar.

Melinda dhe Bill Gejts kanë vendosur t'i japin fund martesës së tyre 27 vjeçare. Ata u njohën për herë të parë në parkingun e kompanisë "Microsoft" në vitin 1987. Gejts se pyeti nëse donte të dilte me të. Ajo refuzoi. Një ose dy orë më vonë, Bill i telefonoi dhe itha se kishte prenotuar një darkë diku po atë mbrëmje.

Shtatë vjet më vonë ata u martuan dhe patën tre fëmijë. Bill dhe Melinda Gejts nuk kanë nënshkruar një marrëveshje paramartesore, pavarësisht pasurisë së madhe. Por ata kanë një marrëveshje për ndarjen e pasurisë, kushtet e së cilës janë sekrete. /"Linkiesta" – Bota.al



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Envert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



## 26 sportistë përfaqësojnë Kosovën në 'Heraklion 2023'

PRISHTINË, 29 GUSHT - 26 sportistë të pesë sporteve të ndryshme do të përfaqësojnë Kosovën në edicionin e tretë të Lojërave Mesdhetare në Rërë "Heraklion 2023", të cilat prej 9 deri më 16 qershor mbahen në qytetin Heraklion të Greqisë. Sportistët vijnë nga sportet e volejbollit në rërë, basketbollit 3x3, hendbollit në rërë, not në ujëra të hapura dhe karate në rërë. Hendbollit në rërë, basketbollit 3x3 dhe karate në rërë përfaqësojnë për herë të parë Kosovën në një ngjarje të tillë. Hendbollit merr pjesë me ekipin e



meshkujve, ndërsa basketbolli 3x3 dhe volejbollit në rërë në të dyja konkurrencat. Dy notarët do të garojnë në disiplinën 5 km në ujëra të hapura, ndërsa dy karateistët në disiplinën kata

individuale. Krahas sportistëve dhe trajnerëve, volejbollit përfaqësohet edhe me gjyqtarin Valon Mustafa. Kosova për herë të parë u përfaqësua në LMR "Patras 2019".

VOLEJBOLL NË RËRË	BASKETBOLL 3X3	KARATE NË RËRË
Melirona Avdullahu	Anile Selmani	Drilon Shala
Yllka Jashari	Agnesa Rrahmani	Mirlind Zekaj
Erion Bajrami	Besjana Martinaj	NOT I HAPUR
Ernal Maliqi	Sara Vraniçi	Arion Budima
	Bardh Rexha	Sindrit Desku
	Donat Rexhepi	
HENDBOLL NË RËRË		
Arbër Neziri		Alma Loki
Ardi Halili		Ventor Gjuka
Dardan Dugolli		
Erbiln Qerimi		
Enis Kuleta		

## Ballkani prezanton Ismajlgecin

SUHAREKË, 29 GUSHT - Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Ballkani ka realizuar edhe një transferim. Marsel Ismajlgeci është lojtari më i ri i skuadrës nga Suhareka. Anëtori i majtë ka luajtur për Tiranën, skuadër me të cilën u shpall kampion i Superiorës në Shqipëri, kurse së fundmi kishte një aventurë edhe në Bosnje, me kampionët e Zrinjskit të Mostarit. "Të dashur tifozë, kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se skuadrës tonë

kampione i është bashkuar edhe një kampion. Anëtori i majtë, Marsel Ismajlgeci, tani është futbollist i Ballkanit. 23 vjeçari ka luajtur për Tiranën, skuadër me të cilën u shpall kampion i Superiorës në Shqipëri, kurse së fundmi kishte një aventurë edhe në Bosnje, me kampionët e Zrinjskit të Mostarit. "Të dashur tifozë, kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se skuadrës tonë



## Fillon shitja e biletave për ndeshjen Kosovë - Zvicër

PRISHTINË, 29 GUSHT - Të martën ka nisur shitja e biletave për ndeshjen Kosovë- Zvicër, e cila luhet me 9 shtator në orën 20:45, në stadiumin "Fadil Vokrri", në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2024". Çmimet e biletave në Veri dhe Jug janë 5 euro, në Lindje kushtojnë 10 euro, në Perëndim 20 euro, ndërsa bileta VIP 80

euro. Një person ka mundësinë të blejë deri në katër bileta, ka njoftuar Federata e Futbollit të Kosovës. "Për të blerë biletën online duhet fillimisht të regjistroheni në platformë, pastaj zgjidhni tribunën e stadiumit dhe më pas e selektoni ulësen e preferuar. Pasi t'i zgjidhni biletat, vazhdoni me

pagesën online, kur të përfundoj blerja online, ju duhet të pritni deri të gjenerohet bileta dhe fatura juaj. Bileta duhet të jetë e printuar në formatin A4, printimi duhet të jetë i kualitetit të lartë. Ndërsa në stadium një person mund të hyjë vetëm me një biletë, pra janë të personalizuar", thuhet në njoftimin e FFK-së.



## Dëmtohet qëllimisht shtegu i ecjes në Tokbahçe



PRISHTINË, 29 GUSHT - Edhe pse ende nuk ka përfunduar puna për përirimin e tij, tashmë shtegu i ecjes në lagjen Tokbahçe në Prishtinë ka pësuar dëmtime. Këto dëmtime, sipas drejtorit të

Drejtorisë për Sport në Komunën e Prishtinës, Granit Rugova, janë të qëllimshme. "E tmerrshme dhe e dhimbshme se si u dëmtua qëllimisht ende pa përfunduar shtegu i ecjes dhe

vrpimit në Tokbahçe. Pse duhet të ndodhë një gjë e tillë... thjeshtë e pabesueshme!!! I dënojmë veprimet e tilla huligane dhe qëllim keqe, dhe i ftojme institucionet përgjegjëse që të

ndjekin rastin deri në fund. Puna do të vazhdojë, sportistët dhe qytetarët do ta shfrytëzojnë shtegun e përfunduar që ju takon shumë shpejtë", ka shkruar Rugova në "Facebook".

## Dortmundi interesohet për Berishën

DORTMUND, 29 GUSHT - Nënkampionët e Bundesligës, Borussia Dortmund janë në kërkim të një sulmuesi, të cilin mesa duket e kanë gjetur dhe janë

gati të bëjnë ofertën për të. Sipas raportimeve më të fundit të medieve gjermane, bëhet fjalë për "bomberin" gjerman me origjinë shqiptare, Mërgim Berisha,

me këtë të fundit që aktivizohet te skuadra e Augsburgut, të cilët nuk pranojnë më pak se 15 milionë euro për kartonin e 25-vjeçarit. Bisedimet

raportohet se kanë nisur dhe pritet që shumë shpejt të arrihet akordi mes dy klubeve dhe Berisha të vihet nën dispozicionin e teknikut Edin Terziq.





## Prishtina 01 mëson kundërshtarët për Main Raund të LK-së

**PRISHTINË, 29 GUSHT** - Kampioni i Kosovës dhe fitues i Kupës së Kosovës në futboll, Prishtina 01 ka mësuar tashmë kundërshtarët e tij për fazën Main Raund të Ligës së Kampionëve në futboll. Prishtina 01 është kualifikuar në "Main

Round" në Ligën e Kampionëve për sezonin 2023/24, lë gjurmë në futbollin evropian, pasi kaloi me sukses në raundin preliminar. Kampioni i Kosovës shkëlqeu në Grupin D, duke kaluar si lider i grupit me 7 pikë, pas dy fitoreve të thella ndaj

Isbjorninn (11:1) dhe Utleiras (5:1), si dhe barazimit 1:1 me KSC Lubawa. Pas kalimit të fazës preliminare, Prishtina 01 u kualifikua në Main Round dhe tashmë ka mësuar kundërshtarët për këtë fazë. Kaunas Zalgirisit (Lituani), Kampuksen Dynamos

(Finlandë) dhe Ael Limassol (Qipro) iu bashkuan skuadrës kryeqytetase. Këto katër skuadra kanë kompletuar Grupin 7 në Main Round. Ndeshjet e Main Raund do të zhvillohet në Lituani më datat 25, 26 dhe 28 tetor.



## SC Gjilani zyrtarizon udhëheqësin e re të klubit

**GJILAN, 29 GUSHT** - SC Gjilani ka konfirmuar ndryshimet në udhëheqësin e klubit. Klubi gjilanas është bërë me aksionarë të rinj, derisa Afrim Velu është emëruar në pozitën e presidentit të klubit. Aksionarët e tjerë, Fatlum Pireva, Qëndrim Demiri, Valmir Emini dhe Shaban Bajrami, janë pjesë e bordit. "Klubi ka një proces të ndërrimit të pronësisë dhe pritjes së investitorëve strategjik për të përmirësuar rritjen e ardhshme të klubit, me qëllimin e vetëm për të përfunduar nga mundësitë si në fushën e blertë ashtu edhe në anën komerciale. Si pjesë e këtij procesi, klubi mori në konsideratë të gjitha alternativat strategjike, duke përfshirë investimet e reja në klub, stabilitetin financiar dhe atë sportiv, si dhe ndërtimin e një ekipi të ri konkurrues pas ndryshimeve të shumta të bëra në afatin kalimtar të verës", thuhet në njoftimin e klubit gjilanas. Bordi i klubit do të bëjë një vlerësim të disa nismave për



ta forcuar klubin, duke përfshirë zhvillimin e infrastrukturës, rritjen e akademisë së klubit, ndërtimin e një strukture kompetitive për ekipin e parë dhe afrimin edhe me të madh të tifozëve me klubin. Drejtuesit e

rinj kanë shprehur falënderimet më të sinqerta për gjithë qytetarët gjilanas dhe jo vetëm, për mikpritjen fantastike dhe durimin e shfaqur në kohët e krizës për klubin, i cili tashmë merr një rrugëtim të ri.

## Leclerc e Hamilton: Red Bull do të dominojë deri në vitin 2026

**MILTON KEYNES, 29 GUSHT** - Pilotet Charles Leclerc e Lewis Hamilton janë të njëjtit mendim se makina Red Bull do të dominojë edhe dy kampionatet e tjerë të Formula 1. Pas garës së fundit në Holandë, dy pilotët e Ferrari e Mercedes kanë pranuar dominimin e makinës austriake, që këtë sezon i ka fituar të gjitha garat. "Nuk do të mjaftojë as 1 apo dy vite. Deri në vitin 2026, kur të ndryshojnë rregullat e garës, Red Bull do të dominojë e fitojë. Sa do që ne përpqemi të rikuperojmë, ata janë më të shpejtë dhe kanë një avantazh shumë të madh ndaj nesh", u shpreh Charles Leclerc, që u tërhoq nga gara e Holandës. I këtij mendimi është edhe Hamilton, që shtoi: "Fakti që kanë një avantazh kaq të madh i jep mundësi Red Bull që të zhvillojnë më herët se ne



makinën e ardhshme. Ne punojmë për të zhvilluar apo ngushtuar diferencat me ta, por

duket e pamundur për sa kohë janë në fuqi këto rregulla. Charles ka të drejtë".

### SHKURT

#### Robert Burcea prezantohet te Llapi

Llapi ka vazhduar me përforcime në afatin kalimtar veror. Skuadra e udhëhequr nga trajneri Tahir Batatina tanimë ka përfunduar repartin e mbrojtjes. Rumuni Robert Burcea është futbollisti më i ri i Llapi i cili ka nënshkruar kontratë një vjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një tjetër. "Robert Burcea nënshkruan me Llapi. Burcea ka bindur drejtuesit e klubit për të nënshkruar me të dhe pas nënshkrimit të kontratës ka filluar stërvitjet me pjesën tjetër të ekipit. 24-vjeçari në kategoritë e reja ka qenë pjesë e Schalke 04, teksa në vijim të saj ka mbrojtur ngjyrat e skuadrave si: Daesti, Zimbru Chisinau dhe së fundmi Ocna Mures. Klubi ka përfunduar gjitha procedurat e regjistrimit të tij dhe Burcea ka të drejtë loje nga ndeshja e ardhshme me Prishtinën", thuhet në njoftimin e Llapi.

#### Uzuni në formacionin më të mirë të javës në La Liga

Myrto Uzuni është përfshirë në formacionin më të mirë të javës së tretë të kampionatit spanjoll. Prestigjiozja spanjolle "Marca" ka publikuar formacionin ideal për këtë javë, duke e vendosur sulmuesin e kombëtares sonë në vijën e sulmit, bashkë me sulmuesin e Barcelonës, Ferran Torres. Beratasit shënoi golin e tij të parë në LaLiga nga pika e bardhë e penaltisë, në ndeshjen ndaj Mallorca. Formacioni: Remiro, Nacho Vidal, Rubio, Blind, Pedraza, Lamine, Vesga, Bellingham, Saul, Ferran Torres, Uzuni.

#### Liverpooli interesohet Joao Felix

Joao Felix nuk është në planet e Atletico Madridit, kurse interesim për të ka shfaqur skuadra e Liverpoolit. Portugezi 23-vjeçar kërkohet edhe nga Barcelona, Aston Villa dhe Al-Hilali, derisa "Los Colchoneros" kërkojnë 12 milionë euro për huazimin e portugezit. Liverpooli e sheh Joao Felix si pasardhës të Salahit, i cili pritet të vazhdojë karrierën në Arabinë Saudite.

#### Hazard i jep fund karrierës si futbollist

Sulmuesi belg Eden Hazard do të zyrtarizojë së shpejti tërheqjen e tij nga futbollit në moshën 32-vjeçare. Ky është lajmi surprizë që ka publikuar e përditshmja britanike, që shpjegon edhe arsyet e tërheqjes së fantazistit belg nga futbollit. Mësohet se menaxherët e tij janë duke u përpjekur që t'i ndryshojnë mendjen Hazardit, që u shkëput nga Real Madrid këtë verë. Me skuadrën "merengues" ai luajti vetëm 76 ndeshje e 7 gola (6 ndeshje sezonin e kaluar), duke mos arritur dot në nivelet e dikurshme, kur luante me Chelsea në Angli. Edhe pse pa kontratë, sulmuesi nuk ka gjetur ende një ekip të ri për të luajtur, ndaj dhe ka vendosur të tërhiqet. Ofertat në adresë të Hazardit nuk kanë munguar, nga MLS (Vancouver Whitecaps), Franca (Lille) dhe Arabia Saudite (4 klube), por sulmuesi belg i ka refuzuar të gjitha propozimet që kanë mbërritur. Dhe krejt papritur pritet të vijë lajmi i bujshëm i tërheqjes së tij nga futbollit edhe pse në një moshë ende të re. Në dhjetor të vitit të kaluar, ai bëri publik lajmin e largimit nga ekipi kombëtar, që së shpejti mund të pasohet nga ai i largimit edhe nga futbollit i luajtur.

## Inzaghi: Djemtë ishin perfektë, Lukaku blerje e madhe e Romës

Trajneri Simone Inzaghi po shijon fillimin e shkëlqyer të sezonit të Interit. Skuadra zikaltër ka marrë pikë të plota në dy ndeshjet e para të Serisë A: "Djemtë ishin shumë të mirë, e

interpretuan mirë që në minutën e parë ndeshjen. Duhej një qasje e shkëlqyer, ndaj një ekipi shumë të motivuar, që luante për herë të parë para tifozëve të tij pas

rikthimit në Serinë A. Djemtë ishin perfektë". "Ata po bëjnë një nënshkrim të shkëlqyer, rikthimi i tij është i mirë për futbollin italian. Jam shumë i kënaqur me lojtarët që kam dhe

me familjen e Interit. Lautaro? Ai është rritur shumë në dy vitet e mia tek Interi, është gjithnjë e më i përgjegjshëm dhe përshtatet në mënyrë të përkryer me mënyrën tonë të

interpretimit të futbollit", ka deklaruar Inzaghi. Trajneri italian pati fjalë të mira edhe për Thuramin, duke thënë se është përshtatur shpejt dhe se e kupton mirë lojën.





Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria –Vlada-Government  
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR  
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSLOVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

**QENDRA E KOMPETENCËS “KUJTIM KRASNIQI” MALISHEVË**

Nr. Prot: 1132/4  
 Datë: 29/08/2023  
 Vendi: Malishevë

**NJOFTIM**

Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë njofton të gjithë operatorët ekonomik të cilë janë të interesuar për aplikim se:

**Lëshohet në shfrytëzim (Qera), Restoranti i shkollës.**

Të interesuarit mund t’i aplikojn në zyrën nr. 4 në objektin e shkollës nga data 30/08/2023 deri me datën 12/09/2023 prej orës 8:00-16:00

**Hapja e ofertave bëhet me daten 12/09/2023 nga ora 13:00.**

**QENDRA E KOMPETENCËS “KUJTIM KRASNIQI” MALISHEVË**

**Kriteret për qiradhënien e restorantit të shkollës**

Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë posedon restorantin me të gjitha pajisjet më moderne nga fusha e gastronomisë.

Kapaciteti i tij siguron plotësimin e nevojave ditore për të gjithë stafin dhe nxënësit e shkollës.

Me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për stafin dhe nxënësit, Bordi i Qendrës së Kompetencës mori vendim në janar 2013 që, restoranti i shkollës ti jepet në shfrytëzim operatorit i cili i plotëson kriteret e poshtë shënuara.

**Parakushtet për kualifikim:**

- Operatori ekonomik duhet të ketë biznesin e regjistruar ne Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe të jetë tatimpagues i rregullt në Administratën Tatimore të Kosovës.
- Operatori duhet të ketë traditë në fushën e gastronomisë
- Të ketë të paguar tatimin në ATK
- Të ketë në stafin e tij punëtorë në fushën e gastronomisë

**Vërejtje: Për të gjitha parakushtet e lartëshënuara kërkohet dëshmia dhe dokumentacioni plotësues! Operatorët ekonomik të cilët nuk i plotësojnë parakushtet, nuk do të kualifikohen në procesin e tenderimit!**

**Kriteret për dhënien në shfrytëzim të restorantit të Qendrës së Kompetencës “Kujtim Krasniqi” – Malishevë**

Të gjithë operatorët ekonomik të cilët janë kualifikuar, do t’u nënshtrohen kriterëve të poshtë shënuara.

- Çmimi i qirasë së restorantit që pretendoni të paguani.
- Ofrimi i një asortimenti të gjerë të produkteve.
- Cilësi e garantuar në produkte dhe shërbim
- **Kërkohet:** Kontrollimi i ushqimit në baza ditore për minimizimin e reziqeve të helmimit dhe problemeve shëndetësore të nxënësit dhe stafit.

**Fituesi i tenderit do të përcaktohet nga çmimi më i lartë i ofruar nga Operatori ekonomik.**



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshejte)

**RESTAURANT**

**SWISS TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- ArbnoreHoxhaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme Ekonomike “Kadri Kusari”.

D.P.T. Instalimi –ASHB shpall të humbur arken fiskale me nr. Serik: DG-06603079.

- Lyra Kendusi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- MuhametMakolli shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të parë të Gjimnazit “AhmetGashi” Prishtinë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Imer Z. Beka B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811332577 Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Tehnoburimi D.D SH.A shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810548307.

- Ibrahim Bajrami shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme “Arkitekt Sinani”.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lejla Peci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme “Xheladin Deda”.

- Kumrije Rexhepi B.I shpall të pavlefshme certifikatën e numrit fiskal 812051100.



